

Komenti i Grupit Blueprint për reformat në gjyqësor mbi Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2022 në fushën e gjyqësorit - Ku jemi dhe çfarë më pas?

Reformat në gjyqësor, ashtu si në raportin e vitit të kaluar¹, tregojnë njëfarë progresi, për dallim nga progresi i kënaqshëm në zbatimin e proceseve reformuese, të shënuara në raportet e Komisionit Evropian (KE) për vitin 2018², 2019³ dhe 2020⁴. Kjo vërehet edhe me zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e mëparshme, mbi të gjitha raportet e vitit të kaluar, të cilat janë kryesisht të njëjta ose të modifikuara. Megjithatë, niveli i përputhshmërisë mbetet i pandryshuar që nga viti 2019, respektivisht Maqedonia e Veriut ka një nivel të caktuar/mesatar avancimi të përgatitjes.




Tabela 1. Tabela është bërë në përputhje me metodologjinë e Institutit për Politikë Evropiane. Progresi në proceset e reformës matet në një shkallë nga -1 deri në 4

¹ KE, Republika e Maqedonisë së Veriut, Raporti për vitin 2021 (Komisioni Evropian 2021) [EC, 'Republic of North Macedonia 2021 Report' (European Commission 2021)] <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2021_en>.

² KE, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raporti i vitit 2018 (Komisioni Evropian 2018) [EC, 'The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2018 Report' (European Commission 2018)] <<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf>>.

³ KE, Republika e Maqedonisë së Veriut, Raporti për vitin 2019 (Komisioni Evropian 2019) [EC, 'Republic of North Macedonia 2019 Report' (European Commission 2019)] <<https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2019-05/20190529-north-macedonia-report.pdf>>.

⁴ KE, Republika e Maqedonisë së Veriut, Raporti për vitin 2020 (Komisioni Evropian 2020) [EC, 'Republic of North Macedonia 2020 Report' (European Commission 2020)] <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/north_macedonia_report_2020.pdf>.




Tabela 2. Tabela është bërë në përputhje me metodologjinë e Institutit për Politikë Evropiane. Përputhshmëria matet në një shkallë nga 1 deri në 5

Progresi këtë vit, si dhe në raportet e vitit 2021, 2020 dhe 2019, është për shkak të zbatimit të Strategjisë së Reformës në Sektorin Gjyqësor 2017-2022 (Strategjia), e cila adreson më tej rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Venecias dhe grupi i ekspertëve të lartë të çështjeve sistematike të sundimit të ligjit. Me këtë, KE-ja thekson rëndësinë e zbatimit adekuat të standardeve evropiane në fushën e drejtësisë dhe rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Venecias dhe grupi i ekspertëve të lartë për çështjet sistematike për sundimin e ligjit.

Është domethënëse në këtë raport që Komisioni Evropian mirëpret procesin e përgatitjes së një Strategjie të re të Gjyqësorit, e cila është duke u zhvilluar në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente bazuar në mësimet e nxjerra. Komisioni vëren gjithashtu se plani i veprimit i modifikuar për zbatimin e Strategjisë ekzistuese të Reformës në Sektorin Gjyqësor duhet të vazhdojë të zbatohet në mënyrë sistematike. Megjithatë, KE e vendos sërish miratimin e projektligjit për procedurën kontestimore në pjesën e rekomandimeve kyçe, si një nga masat legjislative të parashikuara në Strategjinë e re për Reformën në Sektorin Gjyqësor. Zbatimi i Strategjive për burimet njerëzore në gjyqësor dhe në prokurorinë publike, për të cilat KE vëren se ka progres të kufizuar (*limited progress*), është i një rëndësie të jashtëzakonshme. Me këtë Komisioni thekson se në këtë pjesë reformat po zhvillohen me progres më të ulët, për dallim nga vlerësimi i progresit të dhënë për të gjithë sektorin e gjyqësorit. Nevoja për funksionim cilësor të gjyqësorit dikton që nevojat e personelit të planifikohen paraprakisht dhe KE thekson shprehimisht se nevojitet një përsheptim në zbatimin e Strategjive të burimeve njerëzore në gjyqësor dhe në prokurori, nëse numri i gjyqtarëve zvogëlohet me 48 dhe i prokurorëve me 11, kjo edhe për shkak të pensionimeve të planifikuara në muajin qershor.

Sa i përket organeve drejtuese, KE është edhe më e rezervuar për veprimin e Këshillit Gjyqësor si gardian i pavarësisë së gjyqësorit. Ndërsa raporti i vitit 2020⁵ vlerësoi rolin proaktiv të

⁵ KE, Republika e Maqedonisë së Veriut, Raporti për vitin 2020 (Komisioni Evropian 2020) [EC, 'Republic of North Macedonia 2020 Report' (European Commission 2020)] < https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/north_macedonia_report_2020.pdf>.

Përmbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe përfituesit të grantit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

Këshillit Gjyqësor, raporti i vitit 2021⁶ theksoi nevojën që Këshilli Gjyqësor të ruajë rolin e tij si kujdestar i gjyqësorit (drejtësisë). Këtë vit, KE është më kritike dhe vëren se është e nevojshme që Këshilli të forcojë rolin e tij si mbrojtës i pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit, si dhe të përmirësojë aspektin e transparencës. Sa i përket punës së Këshillit të Prokurorëve Publikë, është e nevojshme që Këshilli të arsyetojë vendimet e tij dhe të sigurojë qasje të rregullt të mediave në seancat e tij, gjë që nuk ishte gjithmonë e mundur për shkak të hapësirës së kufizuar dhe kufizimeve në fuqi për shkak të pandemisë Covid-19.

Me rëndësi vendimtare janë detyrimet e dy këshillave, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë, në drejtim të promovimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimit të perceptimeve për pavarësinë e sektorit të drejtësisë. Në këtë drejtim, raporti thekson nënshkrimin e Deklaratës për Gjyqësor të Hapur, e cila pritet të përmirësojë transparencën dhe të rrisë besimin e publikut në gjyqësor.

Për përmirësimin e sistemit AKMIS, theksohet se është e nevojshme të sigurohen të dhëna statistikore të pranueshme, në përputhje me rekomandimet dhe metodologjinë e Komisionit Evropian të Këshillit të Evropës për Efikasitetin e Drejtësisë (SEREJ), për punën si të gjyqësorit ashtu edhe të prokurorisë. Gjithashtu, sistemi AKMIS duhet të jetë plotësisht funksional dhe në përputhje me metodologjinë e re për kompleksitetin e lëndëve dhe metodat e vlerësimit të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.

Që nga qershori i vitit 2020, Këshilli Gjyqësor ka shkarkuar gjashtë gjyqtarë, ndërsa Këshilli i Prokurorëve Publikë ka konfirmuar vendimin për shkarkimin e një prokurori.

Vonesa në përzgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat e larta dhe kryetarëve të gjykatave në qytetet më të vogla vjen si pasojë e aplikimit të metodologjisë së re të vlerësimit, si dhe për shkak të daljes në pension të planifikuar të tre anëtarëve të Këshillit Gjyqësor.

Ashtu si në vitin e kaluar, KE tregon një vëmendje të veçantë kur miraton Ligjin e ri për Akademinë për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë dhe respekton rekomandimet e Misionit Vlerësues nga viti 2018 dhe se AGjPP-ja mbetet e vetmja pikë hyrëse në gjyqësor dhe prokurori dhe për të siguruar një qasje të drejtë dhe transparente ndaj këtyre profesioneve. Theksohet se kohëzgjatja e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët publikë nuk guxon të shkurtohet.

Një hap pozitiv përpara është bërë me rolin proaktiv të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjykatave të apelit për përmirësimin e konsistencës së aktgjyqimeve dhe harmonizimin e praktikës gjyqësore. Gjithashtu, me rolin aktiv të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë në rekrutimin e kandidatëve të rinj dhe bashkëpunimin me Rrjetin Evropian të Trajnimit të Gjyqtarëve (EJTN) dhe Akademinë e së Drejtës Evropiane (ERA). Dështues është fakti që edhe këtë vit, ashtu si edhe vitet e kaluara, Komisioni shpreh shqetësim për buxhetin e ndarë për gjyqësorin dhe prokurorinë publike. Ndryshe nga raporti i vitit të kaluar, këtë vit KE thekson në mënyrë eksplicite nevojën për të gjetur urgjentisht një zgjidhje për pagat e ulëta në sektorin e drejtësisë.

Ligji i ri për ndërmjetësimin theksohet se përmirëson cilësinë e ndërmjetësimit dhe unifikon zbatimin e ligjit nga ndërmjetësuesit e licencuar, megjithatë, puna e vazhdueshme është e nevojshme për të promovuar zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (kontesteve), në bashkëpunim me aktorë të tjerë kyç, si Shoqata e Gjyqtarëve dhe Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë.

⁶ KE, Republika e Maqedonisë së Veriut, Raporti për vitin 2021 (Komisioni Evropian 2021) [EC, 'Republic of North Macedonia 2021 Report' (European Commission 2021)] < https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2021_en>.

Përmbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe përfituesit të grantit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

Rekomandime për adresimin e sfidave të identifikuara në raport

Nga analiza e përmbajtjes së raportit, del se një pjesë e madhe e sfidave dhe rekomandimeve të dhëna në raportet e mëparshme figurojnë edhe në këtë raport. Duke marrë parasysh gjetjet dhe rekomandimet e dhëna, dhe në bazë të gjetjeve të analizave të grupit Blueprint për reformën në gjyqësor dhe organizatave civile që janë anëtare të grupit, në periudhën e ardhshme është e nevojshme:

- Miratimi i Strategjisë së re të Gjyqësorit dhe zbatimi konsekuent i saj. Gjithashtu nevojitet zbatimi i përsheptuar i planit të veprimit të ndryshuar të Strategjisë ekzistuese të Gjyqësorit;
- Miratimi i Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili është në procedurë parlamentare për gati dy vjet;
- Për sa i përket sistemit të automatizuar të informacionit për menaxhimin e lëndëve gjyqësore AKMIS, është e nevojshme të sigurohen të dhëna statistikore të pranueshme, në përputhje me rekomandimet dhe metodologjinë e Komisionit Evropian të Këshillit të Evropës për Efikasitetin e Drejtësisë (SEREJ), për punën si të gjyqësorit ashtu edhe të prokurorisë. Gjithashtu, sistemi AKMIS duhet të jetë plotësisht funksional dhe në përputhje me metodologjinë e re për kompleksitetin e lëndëve dhe metodat e vlerësimit të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave;
- Krijimi dhe vendosja e një zgjidhje softuerike për menaxhimin e automatizuar të lëndëve në prokurorinë publike që do të përmirësojë efikasitetin nëveprimin ndaj kallëzimeve penale, monitorimin e procesit të hetimit dhe ndjekjes penale, si dhe do të mundësojë qasjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Miratimi i Ligjit për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, i cili është në procedurë parlamentare, duke respektuar rekomandimet e misionit vlerësues nga viti 2018 dhe që Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë të mbetet sërish pika e vetme hyrëse në drejtësi dhe prokurori, me çka në veçanti do të sigurohet një qasje e drejtë dhe transparente ndaj këtyre profesioneve;
- Këshilli Gjyqësor të avancojë rolin e tij si mbrojtës i pavarësisë dhe paanësisë së gjyqtarëve dhe të marrë pjesë aktive në të gjitha proceset që kanë të bëjnë me gjyqësorin;
- Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet të jetë e hapur për publikun në seancat e tij përmes prezencës së gazetarëve, publikut profesional, organizatave të shoqërisë civile, si dhe qytetarëve të tjerë të interesuar në seancat e tij. Këshilli për Prokurorët Publik duhet veçanërisht të rrisë transparencën dhe të arsyetojë vendimet e tij;
- Është e nevojshme të rritet buxheti dhe fondet për punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë;
- Të përshejtohet me zbatimin e Strategjive për Burime Njerëzore në Gjyqësor dhe Prokurori, veçanërisht në fushën e punësimit të ri dhe planifikimit të punësimit;
- Rritja e buxhetit të gjyqësorit dhe prokurorisë publike, si dhe buxhetit për ndihmë juridike falas. Presim që me ndryshimet dhe plotësimet e mëposhtme në Ligjin për

Përmbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe përfituesit të grantit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

Buxhetin Gjyqësor, ato t'i përgjigjen plotësisht nevojës për financim të autoritetit gjyqësor dhe të zbatohen në mënyrë konsistente edhe në praktikë;

- Rritja e pagave në sektorin e drejtësisë;
- Afirmimi i ndërmjetësimit me aktivitete promovuese, në bashkëpunim me aktorë të tjerë kyç, si Shoqata e Gjyqtarëve dhe Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë.

- Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj (ShMJR)
- Instituti për Politikë Evropiane (EPI)
- Instituti për të Drejtat e Njeriut (IDNJ)
- Kolaicioni „Të gjithë për një gjykim të drejtë “ (KTGJD)
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
- Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike (QHAI)
- Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni (FShHM)